

LIGJ
Nr.9745, datë 28.5.2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9632,
DATË 30.10.2006 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, 155 dhe 157 pika 3 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, bëhen këto ndryshime e shtesa:

Neni 1

Neni 12 “Regjistrimi dhe licencimi” ndryshohet si më poshtë:

“Neni 12

Regjistrimi dhe ndryshimet

1. Taksapaguesit, subjekte të këtij ligji, regjistrohen, për qëllime fiskale, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me ligjin e posaçëm.

2. Ndryshimet në vendin e ushtrimit të veprimitarisë dhe të të dhënave të tjera tregtare kryhen sipas dispozitave të ligjit për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

3. Ndryshimet e fushës së veprimitarisë së tatimpaguesve, subjekte të këtij ligji, deklarohen pranë bashkisë/komunës, brenda territorit të së cilës ushtrojnë veprimitarinë. Ministri i Financave, në bashkëpunim me ministrin që mbulon çështjet e pushtetit vendor, përcakton me udhëzim procedurat për deklarimin e këtyre ndryshimeve.”.

Neni 2

Pika 1 e nenit 13 “Detyrimi për informim” shfuqizohet.

Neni 3

Në nenin 17 “Kundërvajtjet dhe sanksionet” bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 1 shkronja “a” fjalët “mosregjistrimi ose mosriregjistrimi i vendndodhjes së veprimitarisë ekonomike apo” shfuqizohen.

2. Shkronja “b” shfuqizohet.

3. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Nëse taksapaguesi nuk paguan taksën, gjobën dhe taksën shtesë, zyra e taksave vendos bllokimin e veprimitarisë, deri në çastin e kryerjes së pagesës. Nëse taksapaguesi vazhdon veprimitarinë, pavarësisht urdhrin të bllokimit, dënohet me sekuestrimin e pasurive në vendin e biznesit.”.

4. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Për mosregjistrimin e taksapaguesit apo mosdeklarimin e vendeve të ushtrimit të veprimitarisë zbatohet neni 49/1 i ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.”.

Neni 4

Dispozitë kalimtare

Nenet 1 dhe 2 të këtij ligji hyjnë në fuqi më 1 shtator 2007.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5357, datë 15.6.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu